

E drejta për t'u ankuar

Procedurat për shqyrtimin e ankesave (ligji nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, neni 24).

1. Çdo person, kur çmon se i janë shkelur të drejtat e parashikuara nga ky ligj, ka të drejtë të ankohet në rrugë administrative pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në përputhje me këtë ligj dhe Kodin e Procedurave Administrative.
2. Ankimi administrativ pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale bëhet brenda 30 ditëve pune nga dita kur:
 - a. ankuesi ka marrë njoftim për refuzimin e dhënies së informacionit;
 - b. ka kaluar afati i parashikuar në këtë ligj për dhënien e informacionit.
3. Me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ia kalon atë strukturës që merret me të drejtën e informimit, e cila verifikon faktet dhe bazën ligjore të ankesës. Për këtë qëllim, ai mund t'u kërkojë ankuesit dhe autoritetit publik (UMT-së), kundër të cilit është bërë ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim, si dhe të informohet nga çdo person dhe burim tjetër. Kur e sheh të nevojshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve.
4. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale merr vendim për ankesën brenda 15 ditëve pune nga dita kur është dorëzuar ankimi.
5. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale vendos:
 - a. mospranimin e ankesës kur:
 - i. ka kaluar afati i parashikuar në pikën 2 të këtij neni;
 - ii. ankimi nuk paraqitet në formë shkresore;
 - iii. nuk tregohet emri dhe adresa e ankuesit;
 - b. pranimin e ankesës dhe urdhërimin e autoritetit publik (UMT-së) për të dhënë informacionin e kërkuar, në mënyrë të plotë ose të pjesshme;
 - c. rrëzimin e ankesës, pjesërisht ose tërësisht;
 - d. afatin, brenda të cilit autoriteti publik duhet të zbatojë urdhrin.
6. Në rast se Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale nuk merr vendim përpara mbarimit të afatit të parashikuar në pikën 4, të këtij neni, ankuesit i lind e drejta për t'iu drejtuar gjykatës.

FORMULAR ANKESE

Drejtuar

Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Në bazë të Ligjit Nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”

Emri / Mbiemri¹ :
Adresa:
Qyteti :
Telefon:
E-mail:

Autoriteti Publik :
Adresa:
Qyteti:

Identifikoni saktë Autoritetin Publik/Institucionin ndaj të cilit ankoheni.

Përshkruani çdo veprim të pretenduar si shkelje nga Autoriteti Publik dhe nëse dispononi dokumente bashkëlidhni ato.

Përshkruani çfarë kërkoni nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në përputhje me nenin 24 të ligjit nr.119/2014.

(Data) _____

(Firma) _____

Formulari i ankesës duhet të shoqërohet me formularin e kërkesës për informim drejtuar Autoritetit publik si dhe recetën postare ose emailin drejtuar Autoritetit Publik.

Informacioni në këtë format dhe të dhënat e ID do të përpunohen në përputhje me ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Për sqarime më të detajuara kontaktoni KDIMDP ose koordinatorin e të drejtës për informim.

¹ Në rastet kur informacioni i kërkuar përmban të dhëna personale, kërkohet dokumenti i identifikimit të kërkuarit.

Dëshironi të merrni një informacion publik?

NDIQNI NËNTË HAPAT E MËPOSHTËM:



ose me postë në adresën e institucionit,



ose me e-mail koordinatorit të së drejtës së informimit,



Kërkesa mund të bëhet gjithashtu drejtpërdrejtë përmes portalit Pyetshteti.al



Merrni përgjigje nga institucioni brenda 10 ditëve pune nga dorëzimi i kërkesës,



Afati për kthimin e përgjigjes mund të zgjatet duke e njoftuar menjëherë kërkuessin me jo më shumë se 5 ditë pune.



Ankohuni tek Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale:



1. Kur institucioni refuzon dhënie e informacionit / nuk kthen përgjigje



2. Kur institucioni kthen përgjigje pa vënë në dispozicion dokumentacionin e kërkuar



3. Kur përgjigja e kthyer është e paplotë

Ankimi tek Komisioneri duhet të bëhet brenda 30 ditëve pune nga dita kur kërkuessi ka marrë njoftim për refuzimin e informacionit ose ka kaluar afati për dhënie e tij.



Komisioneri merr vendim për ankesën brenda 15 ditëve pune nga dita e dorëzimit të saj.



Kur Komisioneri nuk merr vendim brenda afatit të mësipërm ose kur nuk bini dakort me vendimin e tij, ankohuni në gjykatën administrative,

FORMAT E DËRGIMIT TË ANKESËS

EMAIL: info@idp.al

DORAZI

POSTË: Rr. e Kavajës, Nd. 80, H1, Tiranë